



Primar / Dorezuar Pimljeni/Prudato Received/Delivered	08-09	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	SKIMSHKK	5234	2022	1/5
Hi Prot Pr Prot No				
Shtojca Prilog Appendix				
Sasia Kolicina Quantity				



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.666/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.666/2022 me datë 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit me numër Nr.02-112/02-0060482/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike “transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.09.2022, mori këtë

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.666/2022 e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet** Vendimi me numër Nr.02-112/02-0060482/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës.
- III. Obligohet** Kryetari i Komunës së Podujevës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën “Inspektor i Komunikacionit”, sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2013 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Komunën e Podujevës sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2013 në pozitën “Inspektor i Komunikacionit”, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, pas kërkesës së datës 20.07.2022 të Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim për transferimin e zyrtarit të lartpërmendur për shkak të volumit të madh të punëve, Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 22.07.2022 nxjerr Vendim me numër protokollit Nr.02-112/02-0060482/22, me të

cilin ankuesin nga pozita „Inspektor i Komunikacionit”, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit e ka transferuar përkohësisht, në interes të institucionit në punë dhe detyra tjera të punës brenda shërbimit civil të Komunës, në pozitën „Zyrtar për Transport”, në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.02-112/02-0060482/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, për transferim të përkohshëm me date 26.07.2022 përmes postës elektronike ne adresën ankesa.kpmsk@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me date 26.07.2022 me numër protokollit 4316/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.08.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli, më datë 12.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.07.2022 me numër protokollit 4316/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 01.07.2013; Vendimit Nr.02-112/02-0060482/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës; Përgjigjen në ankesë e datës 12.08.2022; Shkresë-pëlqim për transferim nga Drejtori i Inspeksionit e datës 22.07.2022; E-mail i datës 26.07.2022; Formulari për kërkesë apo ankesë e datës 22.07.2022; Kërkesë për transferim e datës 20.07.2022; Formulari për kërkesë apo ankesë e datës 21.07.2022; Diplomë me nr.308 e datës 12.05.2012; Formulari i vlerësimit të punës e datës 01.12.2020; Formulari i vlerësimit të punës e datës 03.12.2021, Kopje Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Inspektor i Komunikacionit”, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, pa datë; Kopje Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën „Zyrtar për Transport”, në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, pa datë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, **është e bazuar sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të kësaj çështje juridike, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2013 është punësuar dhe i njëjti ka ushtruar pozitën “Inspektor i Komunikacionit”, në Komunën e Podujevës. Më tutje me datë 20.07.2022 Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit për transferimin e një zyrtari përkatësisht zyrtarit për shkak të volumit të madh të punëve në këtë Drejtori, ndërsa Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit me date 22.07.2022 ka dhënë pëlqimin për transferimin e zyrtarit në këtë rast ankuesit dhe e ka konsideruar si të përshtatshëm për kryerjen e detyrave të punës që lidhen me tushën e shërbimeve publike, mbrojtje dhe shpëtim, si dhe njëkohësisht ka kërkuar që pozita e “Inspektorit të Komunikacionit” të mbulohet për kryerjen e detyrave.

Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 22.07.2022 nxjerr Vendim me numër protokollit Nr.02-112/02-0060482/22, me të cilin ankuesin nga pozita „Inspektor i Komunikacionit”, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit e ka transferuar përkohësisht, në interes të institucionit në punë dhe detyra tjera të punës brenda shërbimit civil të Komunës, në pozitën „Zyrtar për Transport”, në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyratë Publike dhe Rregulloren Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil duke shtuar se ky vendim është nxjerrë nga personi jo kompetent, nuk është përcaktuar kohëzgjatja e transferimit, si dhe Vendimi nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Vendimi me Nr.02-112/02-0060482/22 i datës 22.07.2022 i lëshuar nga Kryetari të Komunës së Podujevës, për transferim të përkohshëm është nxjerrë në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi respektivisht është nxjerrë nga personi jo kompetent, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë transferimin e nëpunësve civil përkatësisht nenin 5 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku është përcaktuar se: *“Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësisht nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet”*, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe nenin 14 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike, Kolegji konstaton se vendimi për transferimin e përkohshëm të ankuesit, është nxjerrë nga personi jo kompetent përkatësisht vendimi është nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Podujevës e jo nga Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore si organ kompetent, andaj mbi këtë baze pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ku përcaktohet që: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”* dhe ka konstatuar se Vendimi me numër Nr.02-112/02-0060482/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës përmes të cilit ankuesi është transferuar përkohësisht, në interes të institucionit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material pasi që përveç se në preambulë ku është përshkruar neni 52 paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratë Publike, në vendim nuk është saktësuar kohëzgjatja e transferimit, e që në bazë të këtij neni është obligim të përcaktohet saktë kohëzgjatja e transferimit, po ashtu kjo parashihet edhe me nenin 4 paragrafin 1, 4 dhe 5 Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit. 4. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligji 5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme* “ andaj në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Podujevës Vendimin me numër Nr.02-112/02-0060482/22 të datës 22.07.2022, për transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita „Inspektor i Komunikacionit”, në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit e ka transferuar përkohësisht, në interes të institucionit në punë dhe detyra tjera të punës brenda shërbimit civil të Komunës, në pozitën „Zyrtar për Transport”, në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, e ka nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyratë Publike i cili përcakton se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori”* si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për

Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, i cili përcakton se, **8.,Përshkrimi i përgjithshëm i punës për kategorinë Profesionale 1. Kategoria Profesionale është kategoria përgjegjëse për zbatimin e detyrave në përputhje me dispozitat ligjore, udhëzimet dhe procedurat e cila ofron mbështetje profesionale dhe administrative, pa u përfshirë në përgjegjësi mbikëqyrëse. 2. Veprimtaria e përditshme kërkon njohuri të përgjithshme profesionale dhe administrative dhe/ose njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar’’, sepse edhe përkundër faktit që ne pajtim me dispozitën e nenit 52 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë thuhet në mënyrë të përgjithësuar se „Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori’, njësia përgjegjëse është e obliguar që në zbatimin e kësaj dispozite të marr parasysh të gjitha specifikat e pozitës së lirë dhe plotësimin e kushteve ligjore të nëpunësit që transferohet respektivisht ne rastin konkret me rastin e transferimit të ankuesit kanë qene të obliguar që të merr parasysh kualifikimet dhe përgatitjen e ankuesit në raport me përshkrimin e detyrave të punës dhe kërkesat specifike të vendit të punës ku është transferuar nëpunësi,**

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave e ka miratuar si të bazuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me shkeljet e bëra pasi që zyrtari është transferuar në një pozitë që nuk është pozitë e të njëjtës kategori sepse njësia përgjegjëse që vendos për transferimin e nëpunësit civil, me rastin e transferimit duhet të marr parasysh dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e në rastin konkret të transferimit të ankuesit është dashur të merret parasysh dispozita e kësaj rregulloreje që përcakton se në kuadër të kategorisë profesionale janë të përfshira këto katër nën kategori: Profesional 1 1.Zyrtar i lartë; Profesional 2 2. Zyrtar i mesëm; Profesional 3 3. Zyrtar Profesional 4 4. Zyrtar Administrativ.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me Nr.02-112/02-0060482/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës, për transferim të përkohshëm, nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se vendimi i atakuar me ankesë nuk përmban të gjitha elementet e aktit administrative konkretisht përmban vetëm pjesën hyrëse, nuk përmban saktë pjesën urdhëruese (dispozitivin), nuk përmban pjesën arsyetuese dhe këshillën juridike, siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmblylëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë’’, dhe pretendimet e ankuesit janë të bazuara.*

Andaj, bazuar si me lartë dhe në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Kolegji, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke u bazuar me nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.02-112/02-0060482/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta

kthej ankuesin në pozitën “Inspektor i Komunikacionit” sipas Akt Emërimit të datës 01.07.2013 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.666/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

MALSORE GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.